

KMSHC-ReSPA, takim për të përcaktuar piketat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërinstitucional për zhvillimin profesional të administratës publike ishte në fokus të një takimi pune mes Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), dhe përfaqësueseve të Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).



Gjatë takimit u diskutua mbi mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme, përfshirë programet e trajnimit për nëpunësit civilë, shkëmbimin e përvojave dhe përfshirjen e administratës shqiptare në iniciativa rajonale që synojnë rritjen e profesionalizmit dhe integritetit në shërbimin civil.

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi për zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike.

“Bashkëpunimi me ReSPA përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të përfituar nga përvojat më të mira rajonale dhe për të forcuar më tej profesionalizmin në shërbimin civil. Përmes

programeve të përbashkëta të trajnimit dhe shkëmbimit të ekspertizës, synojmë të mbështesim një administratë publike më efikase, të përgjegjshme dhe në përputhje me standardet evropiane”, u shpreh Komisionerja.

Nga ana e tyre, përfaqësueset e ReSPA-s; znj. Jelena Mrdak dhe znj. Jelisaveta Tasev vlerësuan rolin e Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në garantimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil dhe theksuan rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet shqiptare.



“ReSPA mbetet e angazhuar për të mbështetur institucionet e administratës publike në rajon përmes programeve të trajnimit, platformave të bashkëpunimit dhe ndarjes së praktikave më të mira”, u shprehën përfaqësueset e ReSPA-s.

Takimi u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt thellimit të bashkëpunimit dhe zhvillimit të iniciativave të përbashkëta që kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve profesionale të administratës publike dhe forcimin e standardeve të shërbimit civil në Shqipëri.